



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë:	11.03.2025
Referencë:	
Për:	z.Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje:	z.Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z.Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Anila Reçica Llugiqi - Drejtoreshë e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport
Lënda:	RAPORT Mujor - SHKURT - 2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë fillimit të vitit 2025, gjegjësisht muajit shkurt, në drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale.

Gjatë gjithë muajit është punuar me staf jo të plotë, por me orar të rregullt.

Në raportimet javore e kemi paraqitur punën e drejtoratit.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- Kemi bërë raportin për muajin janar 2025,
- Kemi filluar procedurat e prokurimit të cilat janë parapare në planin e prokurimit,
- Kemi shënuar aktivitete për Ditën e Pavarësisë së Kosovës:
 1. Janë bërë homazhe në 17 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës,
 2. Është organizuar turniri “Kupa e Pavarësisë 2025” në futboll të vogël dhe volejbol
 3. Është mbajtur programi festiv me ShFMU-të e qytetit të Lipjanit,
 4. Është hapur ekspozita garuese një ditore e punimeve dhe fotografive të realizuara nga nxënësit e shkollave të Lipjanit,
 5. Është shfaqur filmi dokumentar për florën dhe faunën e Lipjanit, në bibliotekën e qytetit,
 6. Është shfaqur shfaqja e baletit në ambientin e bibliotekës së qytetit,
 7. Është mbajtur koncerti festiv për shenimin e 17 vjetorit të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, në sheshin e qytetit të Lipjanit.
- Nderohet dëshmori Xhevdet Breznica në ditën e rënjes së tij.

STATISTIKAT

Në vazhdim paraqesim raportin në formën tabelare:

1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1, -- Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Proces	Të Pazgjidhura
28	11	2	15	-

Tabela- 2, -- Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Në proces	Vërejtje : Te hyrat:
11	9	49	-	24.50€

Tabela- 3, -- Raport për Biblotekën e Qytetit në Lipjan

Vendi	Libra në huazim	Libra të kthyer	Lexues të rinj	Përpunim i librit	Lexues në sallën e leximit	Libra të dhuruara
Spektori për fëmijë	105	113	37	62	277	-
Spektori për të rritur	120	101	5	-	364	0

Tabela- 4, -- Raport për Biblotekën në Gadime

Libra në huazim	Libra të kthyer	Lexues të rinj	Përpunim i librit	Lexues në sallën e leximit
96	88	22	0	0

Tabela- 5, -- Raport për Biblotekën në Shalë

Libra në huazim	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexus në sallën e leximit
90	95	7	30	-

DISKUTIME PUBLIKE

Nuk kemi pasur diskutim publik gjatë muajit shkurt 2025.

TAKIME TJERA

Gjatë muajit shkurt janë realizuar takime fizike me palë, duke mos përjashtuar takimet të cilat i kemi pasur si pjesë e aktiviteteve tona të përditshme.

SFIDAT

Nuk vlerësojmë që kemi hasur në ndonjë sfidë që pengon realizimin e obligimeve të departamentit tone.